



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Up1 Nr. 08-170

1.7.2022

Sh k u p

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe neni 83 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20 dhe 77/21), në lidhje me nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 2, të Ligjit, nenin 51, paragrafi (1) dhe paragrafi (3) dhe nenin 52, paragrafi (2) të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.124/15), neni 28 të Ligjit të Kontesteve Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr.96/19), duke vepruar sipas Propozimit Up1 nr.08-170, datë 17.6.2022, për iniciimin e procedurës për marrje dhe Propozim Up1, nr.08-170, datë 30.6.2022, të Drejtorit të Agjencisë për miratim të vendimit për heqjen e lejes për radiotransmetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, dhe në pajtueshmëri me Konkluzionin, ark.nr.02-2530/2, datë 1.7.2022, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 25-të, të mbajtur më 1.7.2022, miratoi:

VENDIM

**për heqjen e lejes për radio transmetim të
Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Ivanço Pashoski
"RADIO LLAV" SHPKNJP, Ohër**

1. **IHIQET** leja për radiotransmetim, Up1 nr.08-112, datë 5.1.2015, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, sepse poseduesi i lejes e ka ndërprerë transmetimin e shërbimeve programore për më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare dhe arsye të tjera, e cila paraqet bazë për heqjen e lejes në pajtueshmëri me nenin 82, paragrafi (1) nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

2. Ky vendim publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në ueb faqen e Agjencisë dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e komunitetit joshumicë, por që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Ky Vendim është përfundimtar.

ARSYETIM

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, është posedues i lejes për radio transmetim Up1 nr.08-112, datë 5.1.2015, për transmetim nëpërmjet multipleksit tokësor, në nivel lokal (për zonën e komunës Ohër), shërbimi programor muzikë-radio folëse me format të përgjithshëm, në gjuhën maqedonase.

Në pajtueshmëri me nenin 68 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele – LSHMAAV, lejen për transmetim në radio ose televizion i jepet nga Agjencia për një nivel të caktuar të shikueshmërisë ose dëgjueshmërisë në nivel (shtetëror, rajonal ose lokale), ndërsa poseduesi i lejes fiton të drejtën të transmetojë shërbimin programor në radio ose televizion në zonën për të cilën ka marrë lejen.

Në bazë të lejes së marrë për transmetim në radio duke përdorur radiofrekuencat, Agjencia e Komunikimeve Elektronike (AKE) jep miratim për përdorimin e radio frekuencave në pajtueshmëri me Ligjin e Komunikimit Elektronik (LKE). Për përdorimin e

radiofrekuencaven paguhet tarifë vjetore në llogari të AKE për çdo vit aktual paraprakisht, duke filluar nga data e vlefshmërisë së miratimit për përdorim të radiofrekuencave.

Në pajtueshmëri nga sa më sipër u tha dhe për shkak se SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, nuk ka paguar tarifën për përdorim të radiofrekuencave për transmetim në radio - 91,5 MHz, nga ana e AKE-ut u morr Vendim për heqjen e përdorimit të radio frekuencave për SHTR Ivanço Pasheski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër. Për këtë radiodifuzeri ka njoftuar ASHMAA-në me Shkresë-Njoftim (nr. ark. yni 03-1743/1, datë 19.4.2022.), duke deklaruar se do të ketë ndërprerje në program për një kohë të pacaktuar për shkak të Vendimit të AKE-së.

Në pajtueshmëri me nenin 82, paragrafi (1) nënparagrafi 2 të LSHMAAV, ASHMAA do ta heqë lejen për transmetim në radio dhe televizion para skadimit të afatit prej kur është lëshuar dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve, duke paraqitur paraprakisht njoftim me shkrim nëse poseduesi i lejes ka ndërprerë transmetimin e shërbimeve programore në më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare dhe arsye të tjera.

Në lidhje me Njoftimin e lartpërmendur të SHTR-së Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, nga ASHMA-ja drejtuar radiodifuzerit i është dorëzuar shkresë-Njoftim(nr. ark. yni 03-1743/2, datë 19.4.2022), i cili u njoftua se ndërprerja e transmetimit të shërbimit programor në më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare dhe arsye të tjera paraqet bazë për heqjen e lejes në pajtueshmëri me nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LSHMAAV-së, si dhe sa më shpejtë të tejkalojë situatën e konstatuar dhe për këtë të informojë ASHMA-në. Shkresa është pranuar nga radiodifuzeri më 21.4.2022.

Më 27.4.2022., drejtuar ASHMA-së u dorëzua Njoftim nga AKE-së për heqjen e autorizimit për përdorimin e radiofrekuencave të disa shoqërive tregtare radiodifuzive, duke përfshirë dhe SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, nr.0805-178 datë 14.4.2022. (nr. ark. yni 03-1788/1, datë 27.4.2022.).

Me rastin e njoftimit të lartpërmendur nga radiodifuzeri për ndërprerje të transmetimit të shërbimeve programore në radio dhe njoftimin nga AKE për autorizimin e revokuar për përdorim të radiofrekuencave për radiodifuzerin, nga Sektori për mbështetje informative dhe punë të përgjithshme, drejtuar anëtarëve të Këshillit dhe drejtorit të ASHMA-së, është dorëzuar shënim zyrtar (nr. ark. yni 03-1788/2, datë 27.4.2022.), në pajtueshmëri me nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LSHMAAV, shoqërive tregtare të caktuara duke përfshirë dhe SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër të cilët do jenë nën mbikëqyrje administrative me pretekst të Njoftimit të AKE-së për revokim të miratimit për përdorim të radiofrekuencave dhe për të përcaktuar nëse po transmetojnë radio programe deri më 18.5.2022.

Në drejtim të ndërmarrjes së veprimeve të mëtejshme në aspekt të dispozitave nga LSHMAAV, dhe duke pasur parasysh se ASHMA-ja nuk posedon mundësi teknike për regjistrimin e shërbimeve programore në radio në nivel lokal, u dërgua Shkresë-Kërkesë për informacin drejtuar AKE (i yni ark.nr.03-1788/3, datë 28.04.2022.), për paraqitjen e të dhënave të detajuara për ditën prej kur SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, nuk transmeton shërbime programore në radio, si dhe datën e pranimit të vendimit për revokimin e miratuar për përdorimin e radiofrekuencave. Më 19.5.2022. nga ana e AKE-së ishte dorëzuar Njoftim-Dorëzimi i të dhënave të detajuara, Up1 nr. 0805-178, datë 11.5.2022. (i yni ark.nr.03-1788/10), se data e parë e kërkuar në pajtim me orarin kur SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, nuk ka transmetuar shërbime programore në radio është 18.4.2022.

Ndërkohë, punonjës të Shërbimit profesional të ASHMA-së disa herë kanë bërë komunikim telefonik zyrtar dhe elektronik me kryeredaktorin e SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, i cili konfirmoi informacionin se radiodifuzeri nuk transmeton shërbime programore në radio dhe shprehu gatishmërinë që SHTR-së Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, ta ndërpresë vlefshmërinë e lejes bazuar në ligj, duke paraqitur një Deklaratë të noterizuar.

Në bazë të nenit 27, paragrafi (1) të LSHMAAV, ASHMA ka kryer mbikëqyrje administrative, e cila kryhet mbi punën e botuesve të medias në aspekt të pajtueshmërisë së

funksionimit të tyre me kushtet e përcaktuara nga Ligji i Mediave, LSHMAAV dhe rregulloret e miratuara në bazë të tij (neni 29, paragrafi (1) të LSHMAAV).

Në pajtueshmëri me nenin 27, paragrafi (4) të LSHMAAV, Agjencia kreu mbikëqyrje të jashtëzakonshme, në bazë të iniciativës së paraqitur të organeve shtetërore, personat juridikë ose fizikë, si dhe në raste dyshimi sipas detyrës zyrtare të Agjencisë.

Rrjedhimisht nga sa u përmend, Sektori për Mbështetje Informative dhe Punë të Përgjithshme drejtuar Drejtorit të ASHMA-së dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, të jashtëzakonshëm sipas detyrës zyrtare të ASHMA-së (nr. ark. yni 03-2401/1, datë 16.06.2022.), për mbikëqyrjen e kryer më datë 16.06.2022., ndërsa periudha e përfshirë nga mbikëqyrje ishte nga 18.04.2022. deri më 14.06.2022. Gjatë mbikëqyrjes së jashtëzakonshme administrative u deklarua se nga mbikëqyrja e jashtëzakonshme administrative ndaj shërbimit programor në radio të SHTR-së Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, e realizuar në periudhën nga 18.4.2022, deri më 14.6.2022., u konstatua se SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër për më shumë se 30 ditë nuk ka transmetuar shërbime programore në radio, d.m.th. ka ndërprerë transmetimin e shërbimeve programore për më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare dhe arsye të tjera, që është bazë për heqjen e lejes për transmetim në radio, në pajtueshmëri me nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LSHMAAV. Në raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative (i yni ark.nr.03-2401/1, datë 16.6.2022.), në pajtueshmëri me nenin 82, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LSHMAAV, i dha propozim masë drejtorit të Agjencisë të paraqesë propozim drejtua Këshillit për inicim të procedurës për heqjen e lejes për radio transmetim ndaj SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, Up1 nr.08-112, datë 5.1.2015.

Ndërkohë, më datë 16.6.2022., nga ana e SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër drejtuar ASHMA-së është dorëzuar Shkresë - Njoftim (i yni ark.nr.03-2412/1), me të cilën transmetuesi e rikonfirmoi synimin për të ndërprerë veprimtarinë për radio transmetim, sipas ligjit në fuqi dhe kërkoi anulimin e procedurës për përfundimin e vlefshmërisë së lejes.

Ndërkohë, më 17.6.2022. nga punonjës i Sektorit për kontroll dhe monitorim të AKE-së, në rrugë elektronike drejtuar udhëheqësit të Sektorit për mbështetje informative dhe punë të përgjithshme është dërguar një Njoftim se janë kryer matje dhe mbikëqyrje të jashtëzakonshme dhe se SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, më 7.6.2022, nuk e shfrytëzon radiofrekuencën 91,5 MHz, edhe se nuk vërehet në evidencë për rezultatet e matjes të emisionit në radio, të frekuencave të specifikuar.

Në nenin 23, paragrafi 1 alinea 3 të LSHMAAV është përcaktuar se nëse konstatohen parregullsi, lëndime ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore, të miratuara bazuar në ligj, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të ASHMA-së, kundër botuesit të medias, Këshilli i ASHMA-së mund të marrë masë – marrjen (konfiskimin) e lejes.

Procedurën e marrjes së lejes për transmetim të radios ose të televizionit, në pajtim me nenin 83, paragrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e inicon këshilli me propozim të Drejtorit të ASHMA-së. Duke pasur parasysh gjendjen faktike të konstatuar, nëse poseduesi i lejes ka ndërprerë transmetimin e shërbimit programor për më shumë se 30 ditë për shkaqe teknike, financiare ose të tjera, kjo është bazë për marrjen e lejes në pajtim me nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 2 të të njëjtit Ligji, Drejtori i Agjencisë Dr. Zoran Trajčevski në bazë të nenit 83 paragrafi 1 nga LSHMAAV, e në lidhje me nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 2, dorëzoi propozim UP1 nr.08-170 nga 17.06.2022 për inicimin e procedurës për marrjen e lejes për transmetim të radios të SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, UP1 nr.08-112 datë 5.1.2015.

Këshilli i ASHMA-së në seancën e 24-t të mbajtur me datë 20.6.2022., me Konkluzion, nr. ark. 02-2416/2 datë 20.06.2022., e miratoi Propozimin, Up1 nr.08-170 datë 17.06.2022., për inicimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim të radios të SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, Up1 nr.08-112 datë 05.01.2015., paraqitur nga propozuesi, drejtori i Agjencisë, Dr. Zoran Trajčevski.

Në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes për transmetim të radios të SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, UP1 nr.08-112 datë 05.01.2015., dhe në

pajtim me nenin 82, paragrafi 1, nënparagrafi 5 të LSHMAV-së, Agjencia i dërgoi njoftim transmetuesit në fjalë Up11 nr.08-170 me datë 20.06.2022., në të cilin i është theksuar se nëse menjëherë nuk e harmonizon punën në përputhje me LSHMAAV dhe rifillon me transmetimin e programit në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimi i propozimit të drejtorit të Agjencisë, Up1 nr.08-170 datë 17.06.2022., do të marrë vendim për heqjen e lejes së tij për transmetim të radios, pas së cilës në pajtim me nenin 85, paragrafi 2 të LSHMAV-së, transmetuesi do të fshihet nga regjistri i transmetuesve.

Njoftimin Up1 nr.08-170 nga 20.06.2022., ASHMA-ja ia dërgoi SHTR-së Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër në formë të shkruar nëpërmjet postës së shpejtë EMS të postës së RMV-së, megjithatë, duke pasur parasysh se deri në momentin e miratimit të këtij vendimi, nga ASH Posta e RMV-së nuk është kthyer asnjë shkresë në ASHMA për pranimin e njoftimit (Up1 nr.08-170 nga 20.06.2022.), Agjencia ka kryer verifikimin e sistemit elektronik - mbikëqyrjen e dërgesave të ASH Posta e RMV-së përmes së cilit kontrollohet statusi i dërgesës dhe është konstatuar se njoftimi i cituar i është dorëzuar SHA Posta e RMV-ës Ohër me datë 22.06.2022. Informata e cituar me datë 20.06.2022., është dërguar edhe në formë elektronike në adresën elektronike zyrtare të transmetuesit e regjistruar si informacion kontaktues në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila adresë elektronike është e regjistruar në regjistrin e transmetuesve të Agjencisë. Në të njëjtën kohë, njoftimi në formë elektronike i është dërguar kryeredaktorit të SHTR-së Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër.

Me qëllim që të përcaktohet nëse transmetuesi ka respektuar dispozitat e LSHMAAV dhe ka filluar transmetimin e programit në radio, dhe duke qenë se ASHMA nuk posedon mundësi teknike për të regjistruar shërbimet programore të radios në nivel lokal, AKE-së i është dërguar një shkresë - kërkesë për informacion. (Up1 nr. 08-170 nga 24.06.2022), nëse SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër pas datës 20.06.2022 transmeton program në radio. Deri në momentin e marrjes së këtij Vendimi, AKE nuk ka dorëzuar përgjigje rreth njoftimit të dorëzuar nga ASHMA.

Në pajtim me nenin 83, paragrafi 3 të LSHMAV-së, këshilli është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga pranimi i Drejtorit, të fillojë procedurën për heqjen e lejes, të miratojë vendim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

Duke marrë parasysh se poseduesi i lejes Up1 nr.08-112 datë 05.01.2015. - SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, edhe në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita pranimit të Propozimit të Drejtorit të ASHMA-së, Up1 nr.08-170 nga 17.06.2022. nga ana e Këshillit të ASHMA-së, nuk e harmonizon punën në përputhje me LSHMAAV, dhe nuk rifillon me transmetim të programit në radio, në pajtueshmëri me informacionin e dorëzuar nga AKE, nr.ark. 0903-1998/2 nga 29.06.2022 (nr. ynë Up1 nr.08-170 nga 30.06.2022 në pajtim me nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 2 nga i njëjti ligj, e në përputhje me Propozimin Up1 nr. 08-170 datë 30.06.2022. për miratimin e vendimit për marrjen e lejes për transmetim të radios të SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër nga drejtori i Agjencisë dhe Konkluzioni i Agjencisë, nr.ark.02-2530/2 nga 01.07.2022., u miratua vendimi për marrjen e lejes për transmetim në radio të SHTR-së Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, Up1 nr.08-112 nga 05.01.2015., për shkak se poseduesi i lejes e ka ndërprerë transmetimin e shërbimit programor për më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare apo të tjera.

Në pajtim me nenin 84 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, vendimi për heqjen e lejes për transmetim në radio ose televizion është përfundimtar, ndërkaq kundër saj pronari i lejes ka të drejtë që të parashtrijë padi te gjykata kompetente në afat prej 30 ditëve nga pranimi i saj. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lart të miratohet vendimi si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI d.v.**

Udhëzim ligjor: Kundër këtij vendimi për heqjen e lejes për radioemetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive SHTR Ivanço Pashoski "RADIO LLAV" SHPKNJP Ohër, ka të drejtë padie para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i tij.